ALB-BUILDING sh.p.k.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE :	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSEVE TË PARASË	4
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	5 – 22

ALB-BUILDING sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e pozicionit financiar
më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	5	505,618,704	429,394,690
Investime të tjera afatgjata	6	580,607,094	479,777,831
Totali i aktiveve afatgjata		**1,086,225,798**	**909,172,521**
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	7	183,287,246	22,925,896
Llogari të arkëtueshme tregtare	8	1,410,494,890	1,214,266,372
Llogari të arkëtueshme të tjera	9	27,250,234	34,033,169
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	10	123,363,594	105,957,153
Mjetet monetare në arkë e në bankë	11	874,210,367	1,106,920,774
Investime aftashkurtëra	12	198,410,000	60,000,000
Totali i aktiveve afatshkurtra		**2,817,016,331**	**2,544,103,364**
Totali i aktiveve		**3,903,242,129**	**3,453,275,885**
KAPITALI			
Kapitali themeltar		800,000,000	800,000,000
Rezerva ligjore		60,000,000	29,033,891
Fitime të mbartura		743,574,543	586,859,511
Fitimi i ushtrimit		317,854,329	192,681,141
Totali i kapitalit	13	**1,921,428,872**	**1,608,574,543**
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata		-	
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	14	686,994,814	583,432,348
Llogari të pagueshme tregtare	15	871,926,179	916,147,005
Detyrime tatimore	16	49,438,959	19,967,582
Parapagimet e arkëtuara	17	65,778,698	65,790,227
Grante,te ardhura te shtyra e te tjera detyrime	18	55,491,518	114,227,232
Llogari të pagueshme të tjera	19	252,183,089	145,136,948
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**1,981,813,257**	**1,844,701,342**
Totali i detyrimeve		**1,981,813,257**	**1,844,701,342**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**3,903,242,129**	**3,453,275,885**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Doriana Deljallisi (Bilo)
D&D Accounting
Kontabiliste e Miratuar Cert. Nr.159
NUIS: L61803032D

ALB-BUILDING shpk
ALBANIA
KF.35500

ALB-BUILDING sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Shenime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	20	1,883,530,165	1,048,625,979
Të ardhura të tjera	21	15,156,250	9,585,420
Total të ardhura		**1,898,686,415**	**1,058,211,399**
Materiale te para dhe te konsumueshme	22	(1,181,959,861)	(485,431,000)
Shpenzime personeli	23	(133,100,640)	(88,273,820)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	24	(84,825,601)	(99,454,923)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(130,237,481)	(124,064,432)
Fitimi operativ		**368,562,832**	**260,987,224**
Shpenzime financiare Neto	26	6,742,816	(33,828,962)
Fitimi/humbja para tatimit		**375,305,648**	**227,158,262**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		**(57,451,319)**	**(34,477,121)**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	27	(57,451,319)	(34,477,121)
Fitimi/humbja e vitit		**317,854,329**	**192,681,141**
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		**317,854,329**	**192,681,141**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Doriana Deliallisi (Biba)
D&D Accounting
Kontabiliste e Miratuar Cert. Nr.159
NUIS: L61803032D

ALB BUILDING shpk
ALBANIA
NT 35500038

ALB-BUILDING sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Fitimet e Pashpërndara	Fitim/ Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2015	**286,500,000**	**29,033,891**	**811,945,458**	**288,414,053**	**1,415,893,402**
Rritje kapitali	513,500,000	-	(225,085,947)	(288,414,053)	-
Të ardhura totale gjithpërfshirëse për vitin:	-	-	-	192,681,141	**192,681,141**
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse:	-	-	-	-	-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2015	**800,000,000**	**29,033,891**	**586,859,511**	**192,681,141**	**1,608,574,543**
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	-	317,854,329	**317,854,329**
Transferim në fitime të mbartura	-	30,966,109	156,715,032	(187,681,141)	-
Dividendë të paguar	-	-	-	(5,000,000)	**(5,000,000)**
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	**800,000,000**	**60,000,000**	**743,574,543**	**317,854,329**	**1,921,428,872**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga administratori i Alb-Building sh.p.k me ____mars 2017 dhe janë firmosur si më poshtë.

Znj. Donjana Beliallisi
Hartuese e pasqyrave financiare

Donjana Beliallisi (Biba)
D&B Accounting
Kontabiliste e Autorizuar Çert. Nr.159
NUIS: L61626032D

Z. Odhise Bresha
Administrator

ALB-BUILDING sh.p.k
K.F.35500035

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

		Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi pas tatimit		317,854,329	192,681,141
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi		84,825,601	99,454,923
Fitime neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(1,606,787)	-
Tatimi mbi fitimin		57,451,319	34,477,121
Fitimi operativ përpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues		**458,524,462**	**326,613,185**
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues			
Ndryshimi në inventar		(160,361,348)	(18,341,720)
Rënie/ (rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera		(189,445,583)	381,328,715
Rritje/ (rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera		92,296,692	38,475,368
Rënie/ (rritje) në parapagime e shpenzime të shtyra		(17,406,443)	(24,493,798)
Rritje/ (rënie)i në grante dhe të ardhura të shtyra		(58,747,243)	(148,097,895)
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		**124,860,537**	**555,483,855**
Interesa të paguara		-	-
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		(57,451,319)	(34,477,121)
		(57,451,319)	**(34,477,121)**
Aktivitetet investuese			
Blerje e njesive të kontrolluara minus paratë e arketuara		(100,829,263)	37,466,604
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		(162,321,327)	(113,433,861)
Të hyra nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		2,878,499	-
Investime në depozita		(138,410,000)	(60,000,000)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues		**(398,682,091)**	**(135,967,257)**
Aktivitetet financuese			
(Ripagim)/ të hyra nga hua afatshkrter		103,562,466	35,172,748
Dividendë paguar		(5,000,000)	-
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues		**98,562,466**	**35,172,748**
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		**(232,710,407)**	**420,212,225**
Mjetet monetare në fillim të periudhës	11	1,106,920,774	686,708,549
Mjetet monetare në fund të periudhës		**874,210,367**	**1,106,920,774**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 22, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Doriana Dellalliši (Biba)
D&D Accounting
Kontabilkste e Miratuar Cert. Nr.159
NUIS: L61803032D

ALB-BUILDING shpk
ALBANIA

ALB-BUILDING sh.p.k.
Shënime mbi pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(Vlerat janë në Lekë)

1. Informacion i përgjithshëm

ALB-BUILDING sh.p.k. ("Shoqëria") është krijuar më 19.09.1994 me vendim. Veprimtaria e saj sot rregullohet sipas dispozitave përkatëse te ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.
Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është ndërtimi I veprave social- kulturore, rruge, ujesjellesa, shfrytezim, perpunim dhe tregtim I materialeve inerte si dhe prodhim e tregtim I materialeve te ndertimit. Administratori shoqërisë është Z.Odhise Bresha.
Ortake te shoqerise jane Z. Pellumb Beta I cili zoteron 50% te pjesmarrjes dhe Z. Odhise Bresha i cili zoteron 50% te pjesmarrjes.

Selia e shoqërisë ndodhet në Tirane, Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Asim Vokshi, ndertesa nr.14, hyrja 4, apartamenti 6, kodi postar 1016.

Kompania është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me NIPT J69102508C.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Politikat kontabël të aplikuara janë në përputhje me politikat e vitit financiar të mëparshëm.
Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë efektive për periudhat e raportimit financiar që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2016.

- *Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat financiare të konsoliduara", SNRF 12 "Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta" - Njësitë investuese: Aplikimi i përjashtimit të konsolidimit - miratuar nga BE-ja më 22 shtator 2016 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2016)*
- *Ndryshimet në SNRF 11"Marrëveshjet e përbashkëta" Kontabiliteti për Blerjet e interesave në operacione të përbashkëta - të miratuar nga BE-ja më 24 nëntor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)*
- *Ndryshimet në SNK 1 "Paraqitja e pasqyrave financiare" Paraqitja Fillestare - miratuar nga BE-ja më 18 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)*
- *Ndryshimet në SNK 16 "Aktivet Afatgata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje"- Sqarimi i Metodave të pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit - të miratuara nga BE-ja më 2 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).*
- *Ndryshimet në SNK 27 "Pasqyrat financiare individuale"- Metoda e kapitalit neto në pasqyrat financiare të veçanta - e miratuar nga BE-ja më 18 dhjetor 2015 (në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016)*
- *Ndryshimet në standardet e ndryshme "Përmirësimet në SNRF-të (cikël 2012-2014)" që rezultojnë nga projekti për përmirësimin vjetor të SNRF (SNRF 5, SNRF 7, SNK 19 dhe SNK 34) kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin - miratuar nga BE-ja më 15 dhjetor 2015 (ndryshimet duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016).*
  Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim material në pasqyrat financiare të kompanisë.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF) (Vazhdim)

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuara

Në datën e aprovimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet e mëposhtme, interpretimet dhe rishikimet janë emetuar, por nuk jane ende efektive:

- *SNRF 9 "Instrumentat Financiarë" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018)*
- *SNRF 15 "Të ardhurat nga Kontratat me Klientët" dhe amemdime të mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018)*
- *SNRF 16 " Qiratë" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019)*
- *Ndryshimet në SNRF 2 "Pagesat e bazuara në aksione" (Klasifikimi dhe matja e pagesës të bazuar në aksione (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2018).*
- *Ndryshimet në SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit"- Aplikimi i SNRF 9 "Instrumentat Financiarë" me SNRF 4 "Kontratat e Sigurimit" (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2018 ose kur SNRF 9 "Instrumentat Financiarë" aplikohet për herë të parë).*
- *Ndryshimet në SNRF 10 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara" dhe SNK 28 "Investimet në pjesëmarrjet dhe në sipërmarrjet e përbashkëta"- Shitja ose Kontributi i aseteve ndërmjet një investitori dhe ortakut ose sipërmarrjet e përbashkëta dhe ndryshime të mëtejshme (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018)*
- *Ndryshimet në SNK 7 "Pasqyra e Flukseve Monetare"- Paraqitja fillestare (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 janari 2017)*
- *Ndryshimet në SNK 12 "Tatimi mbi të ardhurat"- Njohja e detyrimeve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuara (efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017)*
- *Ndryshimet në SNK 40 "Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara"- Transferimet e aktiveve afatgjata materiale të investuara (efektive për periudhat vjetore që fillojne më ose pas 1 janarit 2018)*
- *Ndryshime të standardeve të ndryshme "Përmirësime të SNRF-ve (cikli 2014-2016)", që rrjedhin nga projekti vjetor i përmirësimit të SNRF-ve (SNRF 1, SNRF 12, IAS 28), kryesisht me qëllim që të shmangin mospërputhjet dhe të qartësojnë formulimin (Ndryshimet në SNRF 12 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017 dhe ndryshimet në SNRF 1 dhe SNK 28 duhet të zbatohen për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018).*

Shoqëria ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

3. Bazat e përgatitjes

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") te BSNK-se.

3.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

3.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

3.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

3.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientit për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientit, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	**31 dhjetor 2016**	**31 dhjetor 2015**
EUR/Lek	135.23	137.28
USD/ Lek	128.17	125.79

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.
Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.
Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali i nenshkruar

Kapitali i nënshkruar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.
Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.
Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proçes" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.
Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.
Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2016 dhe 2015 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndërtesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri dhe paisje pune	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20%
Paisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25%
Mobilje dhe orendi	Vlera e mbetur	20%

Toka nuk amortizohet.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.
Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

4.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

4.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria ka vetem qira operative.

4.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.
Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.
Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2016 eshte 15% (2015: 15%).
Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burime diferencash të perkohshme për njohjen e tatimit të shtyrë.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

4.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.14. Krahasueshmeria e informacionit kontabel

Kur eshte e nevojshme, shifrat krahasuese axhustohen (rregullohen) ne konform me ndryshimet ne paraqitje ne periudhen aktuale raportuese. Ndryshimet jane kryer per te paraqitur me mire natyren e biznesit te Shoqerise. Ato aplikohen retrospektivisht.

5. Aktivet afatgjata materiale

	Toka, troje dhe terrene	Ndërtesa	Makineri dhe Pajisje	Pajisje zyre dhe informatike	Në proces	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 janar 2015	**86,609,338**	**16,169,886**	**1,004,236,176**	**6,150,006**	**8,187,500**	**1,121,352,906**
Shtesa			109,111,466	4,322,395		113,433,861
Transferime		8,187,500			(8,187,500)	-
Pakësime						-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	**86,609,338**	**24,357,386**	**1,113,347,642**	**10,472,401**	**-**	**1,234,786,767**
Shtesa	200,000	4,290,400	150,964,912	6,866,015		162,321,327
Pakësime nga shitja			(10,988,320)			(10,988,320)
Nxjerrje jashtë përdorimit			(60,251,800)			(60,251,800)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	**86,809,338**	**28,647,786**	**1,193,072,434**	**17,338,416**	**-**	**1,325,867,974**
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2015	-	1,607,249	700,353,162	3,976,743		705,937,154
Amortizimi i vitit			97,588,844	1,866,079		99,454,923
Kthim amortizimi						-
Gjendja më 31 dhjetor 2015	**-**	**1,607,249**	**797,942,006**	**5,842,822**	**-**	**805,392,077**
Amortizimi i vitit		1,244,767	76,581,936	1,869,007		79,695,710
Pakësime nga shitja			(9,716,608)			(9,716,608)
Nxjerrje jashtë përdorimit			(55,121,909)			(55,121,909)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	**-**	**2,852,016**	**809,685,425**	**7,711,829**	**-**	**820,249,270**
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2015	**86,609,338**	**22,750,137**	**315,405,636**	**4,629,579**	**-**	**429,394,690**
Gjendja më 31 dhjetor 2016	**86,809,338**	**25,795,770**	**383,387,009**	**9,626,587**	**-**	**505,618,704**

6. Investime te tjera afatgjata

Investimet e tjera afatgjata detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 :

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Pjesëmarrje dhe financime Alb Energji	455,567,453	429,397,705
Pjesëmarrje dhe financime SETA	125,039,641	50,380,126
	580,607,094	**479,777,831**

7. Inventari

Inventari më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohet si më poshte:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Lëndë e parë dhe materiale të tjera	183,250,386	22,126,696
Mallra	36,860	799,200
	183,287,246	**22,925,896**

8. Llogari të arkëtueshme tregtare

Balanca e llogarive të arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Klientë	1,410,494,890	1,214,266,372
	1,410,494,890	**1,214,266,372**

9. Llogari të arkëtueshme të tjera

Balanca e llogarive të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Paradhënie punonjësve	18,692,545	14,850,296
Parapagime për doganën	2,521,689	155,871
Tatim mbi fitimin	-	18,937,002
Të tjera të drejta	-	90,000
Tatim në burim	36,000	-
Hua Star Tek	6,000,000	-
	27,250,234	**34,033,169**

10. Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra të Shoqërisë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Shpenzime të shtyra - Mali i Robit	81,463,355	81,463,355
Detyrime tatimore të apeluara	18,493,798	18,493,798
Shpenzime të tjera të shtyra	-	6,000,000
Paradhënie për mallra dhe shërbime	15,934,983	-
Paradhënie qiraje	7,471,458	-
	123,363,594	**105,957,153**

11. Mjete monetare në arkë e në bankë

Balanca e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Mjete monetare në bankë	**873,253,497**	**881,747,923**
Në Lekë	585,878,997	361,715,736
Në monedhë të huaj	287,374,500	520,032,187
Mjete monetare në arkë	**956,870**	**948,948**
Në Lekë	956,870	388,351
Në monedhë të huaj	-	560,597
Depozita në bankë	-	224,223,903
	874,210,367	**1,106,920,774**

12. Investime afatshkurtra

Investimet afatshkurtra të kompanisë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Depozita Intesa SanPaolo	60,000,000	60,000,000
Depozita Societe Generale Albania	138,410,000	-
	198,410,000	**60,000,000**

13. Kapitali

Vlera e kapitalit themeltar më 31 dhjetor 2016 është 800,000,000 Lekë i zotëruar nga Odhise Bresha 50% dhe Pëllumb Beta 50%.

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Numri I kuotave	2	2
Vlera nominale (në Lekë)	400,000,000	400,000,000
Kapitali i nënshkruar	**800,000,000**	**800,000,000**

Rezervat ligjore të kompanisë më 31 dhjetor 2016 janë në vlerë 60,000,000 Lekë (2015: 29,033,891 Lekë)
Fitimet e mbartura të kompanisë me 31 dhjetor 2016 janë në vlerë 743,574,543 Leke (2015: 586,859,511 Lekë)

14. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Marrëdhënie me shoqëri të lidhura	680,121,477	573,443,161
Hua të tjera	6,873,337	9,989,187
	686,994,814	**583,432,348**

15. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Furnitorë	871,926,179	916,147,005
	871,926,179	**916,147,005**

16. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore të kompanisë më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë :

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	3,187,778	1,949,752
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	419,274	285,842
Tatim fitimi	10,036,762	-
TVSH për t'u paguar	35,795,145	16,943,400
Të tjera tatime	-	788,588
	49,438,959	**19,967,582**

17. Parapagimet e arkëtueshme

Parapagimet e arkëtueshme më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë :

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Parapagime të arketuara-Projekti Mali i Robit	65,018,169	65,018,169
Parapagime për Ismail Qemalin	760,529	772,058
	65,778,698	**65,790,227**

18. Grante,të ardhura të shtyra e të tjera detyrime

Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë :

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Të ardhura të shtyra	55,491,518	114,227,232
	55,491,518	**114,227,232**

19. Llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë të pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Detyrime për dividend	-	66,788,963
Të tjera detyrime ndaj ortakëve	252,183,089	78,347,985
	252,183,089	**145,136,948**

20. Të ardhura

Të ardhurat nga shitja për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga veprimtaria e ndërtimit	1,870,207,974	1,043,936,193
Të ardhura të tjera nga veprimtaria e zakonshme	13,322,191	4,689,786
	1,883,530,165	**1,048,625,979**

21. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 paraqiten si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga komisione dhe shërbime të tjera	1,999,998	7,634,583
Të ardhura nga donacione	-	945,654
Të ardhura neto nga shita e aktiveve afatgjata materiale	1,606,787	115,983
Të ardhura nga qiraja	11,255,337	-
Të ardhura të tjera	294,128	889,200
	15,156,250	**9,585,420**

Të ardhura neto nga shita e aktiveve afatgjata materiale	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Të ardhura nga shitja e aktiveve materiale	2,878,499
Vlera kontabël neto e aktiveve materiale të shitura	(1,271,712)
	1,606,787

21. Të ardhura të tjera (vazhdim)

Rakordimi i të ardhura kontabilitet me qarkullimin (FDP)

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Qarkullim i tatueshem	1,862,230,223
Zbriten autofaturimet	(21,007,810)
Shtohen të ardhura të marra nga viti 2015	114,227,232
Zbriten të ardhurat e shtyra për periudhat e ardhëshme	(55,491,518)
Zbritet vlera kontabël neto e aseteve të shitura paraqitur për neto	(1,271,712)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	1,898,686,415
Sipas kontabilitetit	**1,898,686,415**
Diferenca	-

22. Lëndë të para dhe materiale të konsumueshme

Shpenzimet për materialet e para dhe të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 janë si më poshtë :

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Materiale të para dhe të tjera	510,934,716	387,625,786
Punime nga të tretë	480,890,392	53,447,390
Lendë djegëse	136,764,051	21,447,798
Materiale ndihmëse	48,049,164	22,910,026
Qira mjetesh	5,321,538	-
	1,181,959,861	**485,431,000**

23. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime për paga	114,202,127	75,845,952
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	18,898,513	12,427,868
	133,100,640	**88,273,820**

24. Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi

Shpenzimet e amortizimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Shpenzime amortizimi	84,825,601	99,454,923
	84,825,601	**99,454,923**

25. Shpenzime të tjera

Shpenzime të tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Pjesë këmbimi e të tjera materiale	40,312,807	224,597
Blerje, energji, avull, ujë	1,308,399	173,385
Shërbime e punime nga të tretë	76,960	2,788,454
Mirëmbajtje e riparime	2,918,398	2,617,563
Siguracione	3,254,086	2,199,948
Shpenzime udhëtimi e dieta	37,760,080	87,038,473
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	1,788,191	2,746,723
Shpenzime transporti	-	6,293,938
Shpenzime për shërbimet bankare	23,133,861	11,317,776
Taksa e tarifa të ndryshme	4,135,232	2,205,813
Gjoba dhe dëmshpërblime	-	2,128,471
Shpenzime qiraje	1,835,200	-
Donacione të dhena	1,935,600	-
Të tjera shpenzime	11,778,667	4,329,291
	130,237,481	**124,064,432**

26. Të ardhura / (shpenzime) financiare të tjera neto

Të ardhura /shpenzime financiare të tjera neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 2015 detajohen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Të ardhura nga interesat	1,576,525	6,879,673
Humbje nga këmbimet valutote	(12,524,188)	(53,529,443)
Të ardhura nga këmbimet valutore	17,690,479	12,820,808
	6,742,816	**(33,828,962)**

27. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
Fitimi para tatimit	**375,305,648**	**227,158,262**
Shpenzime të panjohura	**7,703,147**	**2,689,211**
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	**383,008,795**	**229,847,473**
Shpenzime tatim fitimi	(57,451,319)	(34,477,121)
Fitimi Neto (pas tatimit)	**317,854,329**	**192,681,141**

28. Palët e lidhura

Balancat dhe transaksionet me palët e lidhura më 31 dhjetor 2016 dhe 31 dhjetor 2015 paraqiten si më poshtë:

29. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, dhe mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave te interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

Shoqeria nuk eshte eshte e ekspozuar ndaj riskut te normave te interesit per shkak se nuk ka hua nga institucionet financiare.

29. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operacionale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.
Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Risku i Likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkuruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrimeve.

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmerr transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme

30. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiare perfshijne aktivet dhe detyrimet financiare.
Aktivet financiare përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbëhet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proçes likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta te të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrojnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

31. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme
Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë kolektive dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

Në datën e raportimit nuk ka ndonjë tregues që llogaritë e arkëtueshme të jenë zhvlerësuar.

32. Angazhime dhe pasiguri

Detyrimet tatimore
Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015.
Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

33. Ngjarje pas datës së raportimit finaciar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korrigjim ose shënime në pasqyrat financiare.

Doriana Dellallisi (Biba)
D&D Accounting
Kontabiliste e Miratuar Cert. Nr.159
NUIS: L61803032D

ALB-BUILDING sh.p.k.
ALBANIA